



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (KO), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

C1 Pasuritë kapitale në PVF ishin nënvlerësuar për vlerën 854,870€, pasuritë jokapitale ishin mbivlerësuar për vlerën 32,785€, si dhe stoqet ishin mbivlerësuar për 34,000€, për shkak të mangësive si: mos regjistrimit të pagesave të investimeve kapitale, regjistrimit të gabuar të vlerës së tyre, si dhe regjistrimit të pasurive në kategorinë e gabuar.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në dy (2) procedura të prokurimit, nuk ishin respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit;
- A2 Në një rast në vlerë 9,900€, përfituesi i subvencionit nuk kishte siguruar raportin financiar me dëshmitë e kërkuara sipas marrëveshjes për subvencionim;
- A3 Në një rast të ndarjes së subvencionit në vlerë 26,000€, nuk ishin respektuar të gjitha kriteret e thirrjes publike;
- A4 Në tri (3) kontrata për punë, ka pasur rritje të sasive në pozicione, pa marrë aprovimet e duhura;
- B1 Në 10 raste të pagesave, nuk ishin respektuar hapat e përcaktuara për procedim të pagesave sipas rregullave financiare;
- B2 Mangësi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ndër çështjet më me fokus dhe që ka ndikuar në opinionin financiar të auditimit është nënvlerësimi i pasurive kapitale si pasojë e menaxhimit jo të mirë të regjistrave të pasurive jofinanciare.

Kontrollet mbi të hyrat kanë nevojë të forcohen tek procedurat mbi shfrytëzimin e pronave komunale si dhe marrja e masave në mbledhjen e borxheve nga shfrytëzuesit e pronave si dhe nga tatimi në pronë.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi kontratave publike, me ç'rast kanë ndodhur ndryshime në kushtet e kontratës pa marrë aprovimet e duhura, mangësi në procesin e subvencionimit si dhe raportimit të tyre, si dhe mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave gjatë procedurave të prokurimit. Poashtu, janë vërejtur edhe raste të keqklasifikimit të shpenzimeve për shkak të planifikimit të projekteve në kategoritë jo të duhura ekonomike.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, katër (4) rekomandime të përsëritura dhe dy (2) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive ishte 199,208€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 137,930€, ndërsa 61,278€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimi.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Nënvlerësimi i pasurive kapitale në PVF, dhe mbivlerësimi i pasurive jokapitale dhe stoqeve

Gjetja

Bazuar në Rregulloren MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6 Regjistri i pasurive jo financiare paragrafi 3, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Poashtu, neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i kësaj rregullore përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim.

Nga testimi i mostrave kemi vërejtur se pasuritë kapitale ishin nënvlerësuar për vlerën 854,870€, pasuritë jokapitale ishin mbivlerësuar për vlerën

32,785€, si dhe stoqet ishin mbivlerësuar për 34,000€, për shkak të mangësive si në vijim:

- 13 pagesa në vlerë 430,896€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK;
- Një pagesë në vlerë 428,781.80€, ishte regjistruar gabim në vlerë 42,808€, si dhe pagesa në vlerë 113,215€ ishte regjistruar gabim në vlerë 123,215€;
- Vetura e dhuruar si donacion nga Ministria e Shëndetësisë në vlerë 34,000€, tanimë me vlerë neto 32,785€, nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK, por ishte regjistruar në e-pasuri, duke shkaktuar nënvlerësim të pasurive kapitale dhe mbivlerësim të e-pasurisë për këtë vlerë. Kjo veturë poashtu figuronte e regjistruar te stoqet me vlerën blerëse 34,000€, duke shkaktuar mbivlerësim të regjistrit të stoqeve.
- Pagesa në vlerën 760,773€ e realizuar në vitin 2023 për projektin “Koogjenerimi - shtrirja e rrjetit të sistemit të ngrohjes qendrore”, i cili është ende në fazën e investimit në vijim, ishte regjistruar si pasuri në përdorim. Si rezultat i kësaj, pasuria është zhvlerësuar për 15,216€ ende pa u finalizuar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i disa faktorëve siç janë: mungesa e zyrtarit të pasurisë, moskoordinimi i duhur në dërgimin e lëndëve për regjistrim nga zyra e financave tek zyrtari i ngarkuar për regjistrim të pasurive dhe gabimeve gjatë regjistrimit të pasurive nga zyrtari përkatës.

Pas dërgimit të draft raportit në entitet, komuna ka marrë veprime duke i regjistruar pagesat në regjistrin e pasurive në SIMFK, dhe ka korrigjuar regjistrimet e bëra gabim.

Ndikimi

Mosregjistrimi i pasurive si dhe mangësitë në regjistrimin e tyre, ndikojnë menaxhimin jo të mirëfilltë të regjistrave për pasuri dhe në prezantimin jo të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive kapitale, jokapitale dhe stoqeve në PVF.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që pasuritë kapitale, pasuritë jokapitale dhe stoqet, regjistrohen dhe raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësitë në procesin e vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit

Gjetja Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit, në dy prej tyre kemi vërejtur mangësitë gjatë procesit të vlerësimit, si në vijim:

- Tek kontrata për “Renovimi i Xhamisë në fshatin Hamidi” në vlerë prej 23,820€ në dosje të tenderit (DT) tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar që të sigurohen dëshmitë si: Lista e stafit e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin, eksperiencën dhe pozicionin e angazhuar me para kontratë në kompani. OE fitues kishte bashkangjitur listën e stafit, mirëpo në asnjë dokument nuk është dëshmuar eksperiencia e stafit, siç është kërkuar në DT dhe komisioni i vlerësimit nuk kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE; dhe
- Tek kontrata për “Auto larje për vetura zyrtare” në vlerë totale indikativë 24,192€, në dosje të tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar që të sigurohen dëshmitë si: Lista e stafit e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe profesionin. OE fitues kishte bashkangjitur listën e stafit, mirëpo nuk është dëshmuar profesioni i stafit, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e vlerësimit jo korrekt apo mos kompetencës së komisioneve të vlerësimit, për t`i vlerësuar me kujdes ofertat dhe për t`i analizuar dëshmitë e ofruara në raport me kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.

Ndikimi Gabimet në procesin e vlerësimit të tenderit nga ana e komisionit, kanë ndikuar që të rekomandohen operatorët ekonomik për kontratë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për dhënie të kontratës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Raportim i mangët nga përfituesit lidhur me subvencionet

Gjetja Sipas nenit 22 të Rregullores së Komunës Nr 1-108 të datës 25.11.2016 si dhe në marrëveshjen në mes të OJQ-së dhe Komunës sipas nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2, përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar me projekt propozim.

Tek projekti i subvencionuar nga komuna "Ngritja e nivelit të basketbollit" në vlerë prej 9,900€ kemi identifikuar se raportimi i shpenzimeve të realizuara nga klubi i basketbollit nuk ishte në harmoni me marrëveshjet në mes komunës dhe përfituesit. Kjo ngase, kontratat e stafit që lidhen me aktivitetet e klubit në vlerë 9,550€ nuk kishin dëshmi pagese ashtu siç kërkohet në marreveshje. Poashtu, faturat tjera kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve sportive për basketboll, të cilat nuk kishin arsyeshmëri për realizimin e aktivitetit ngase nuk i përkasin periudhës së raportimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve në fushën e monitorimit të subvencioneve, dhe vlerësimit të raporteve narrative dhe financiare nga ana e komisionit përgjegjës.

Ndikimi Shfrytëzimi i subvencioneve nga përfituesit dhe raportimi i tyre jo në përputhje me marrëveshjen dhe rregulloren komunale, rezulton me vlerë të dobët të parasë së shpenzuar nga komuna dhe mos arritjen e objektivave për subvencionet e dhëna.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e fondeve nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mangësi gjatë vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve**

Gjetja Sipas nenit 8 të Rregullores së Komunës Nr 1-108 të datës 25.11.2016, Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpallje publike dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Gjatë vlerësimit të aplikacioneve për projektet e subvencionuara nga komuna në marrëveshje bashkëfinancimi me Islamic Relief Kosova, kemi vërejtur se në një rast për projektin "Mbështetje e fermerëve me motokultivator" në vlerë 26,000€, përfituesi nuk kishte përmbushur kriterin specifik që duhet të jetë banor i Komunës së Obiliqit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni kishte vlerësuar si të mirëqenë pronësinë e përfituesit e cila ishte në territorin e Komunës.

Ndikimi Përzgjedhja e aplikantëve për subvencionim, të cilët nuk i përmbushin të gjitha kriteret e kërkuara, mund ndikojë në favorizimin e përfituesve të caktuar, si dhe në trajtimin jo të barabartë të aplikuesve për përfitim të

subvencionit.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e vlerësimit të kërkesave për subvencionim, ashtu që përzgjedhja e përfituesve të bëhet në përputhje të plotë me kriteret e vendosura në thirrjen publike për subvencionim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Ndryshimet në kushtet e kontratës pa aprovimet e duhura

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 71.1 Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Ne kemi vërejtur se në tri (3) kontrata për punë, ka pasur rritje në sasi të realizuara të pozicioneve/nënpozicioneve të caktuara, por pa e ndryshuar vlerën totale të kontratës, të autorizuara nga menaxherët e kontratave. Për këto ndryshime, nuk kishte amandamentim të kontratës, nuk ishte kërkuar aprovimi zyrtar nga projektuesi dhe as nga Kryetari i Komunës.

Ndryshimet në sasi të kontraktuara kishin ndodhur në kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Ndërtimi i sallave të ed.fizike në SHFMU Abdurrahman Gërguri Dardhishtë dhe SHFMU Dr.Ibrahim Rugova Mazgit i Lartë" në vlerë 1,088,088€, kishte rritje të sasive të realizuara në 64 pozicione dhe nënpozicione të kontratës në vlerë 74,460€, apo deri në 3000% rritje të sasisë në pozicione të caktuara, të kontraktuara;
- Në kontratën "Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve rurale në fshatin Dardhishtë" në vlerë 236,282€, kishte rritje të sasive të realizuara në 22 pozicione dhe nënpozicione të kontratës në vlerë 12,004€, apo deri në 162% rritje të sasisë në pozicione të caktuara, të kontraktuara;
- Në kontratën "Koogjenerimi-shtrirja e rrjetit të sistemit të ngrohjes qendrore" në vlerë 11,849,684€, kishte rritje të sasive të realizuara në 51 pozicione dhe nënpozicione të kontratës në vlerë 873,077€, apo deri në 2,732% rritje të sasisë në pozicione të caktuara, të kontraktuara;

Këto kishin ndodhur si pasojë e mosplanifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe mos funksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me menaxhimin e kontratave.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës së kontraktuar, në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmime se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë konform kërkesave të projektit dhe krijon mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. Kjo rrjedhimisht mund të shpie në tejkalimin e kontratës.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të forcojë llogaridhënien lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguruar se për cdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat për marrjen e aprovimeve të duhura

sipas rregullave të prokurimit/aplikueshme dhe amandamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mosrespektimi i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesave të Rregullës Financiare

Gjetja

Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 25 Çertifikimi i dokumentacionit për pagesë përcakton se para autorizimit të pagesave dokumentacioni duhet të jetë i kompletuar dhe kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur. Gjithashtu, neni 22 parasheh hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj operatori ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Gjatë auditimit, ne kemi identifikuar se:

- Në dhjetë raste në vlerë prej 1,469,930€, urdhërblerjet ishin bërë pas pranimit të mallrave/shërbimeve, punëve si dhe pas pranimit të faturës; dhe
- Në tri raste në vlerë 102,970€ zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallrave/shërbimeve, punëve si dhe pas pranimit të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mosaplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas të bëhet pranimi i mallrave/punëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja

Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23, përcakton se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës dhe kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen. Më tej, pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Gjatë auditimit, kemi identifikuar dy (2) raste të shfrytëzimit të pronës komunale, ku kontratat për shfrytëzimin e tyre ishin skaduar. Megjithatë, pronat vazhdonin të përdoren dhe të faturohen nga komuna pa kontrata të

vlefshme në fuqi. Në këto situata, procedurat për rinovim nuk ishin ndjekur, duke lënë aktivitetet e shfrytëzimit të pronave pa mbështetje ligjore.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së marrjes së veprimeve konkrete nga departamentet përgjegjëse, për të zhvilluar procedurat e duhura lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Ndikimi

Shfrytëzimi i pronave komunale përtej periudhës së caktuar në kontratë është në mospajtueshmëri me kërkesat ligjore si dhe ndikon në mospërmbushjen e detyrimeve nga ana e shfrytëzuesve të pronës komunale.

Rekomandimi B2

Kryetari të sigurojë që të gjitha pronat pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Po ashtu, të sigurojë që të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien e tyre në shfrytëzim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 1,639,776€, derisa janë shpenzuar 1,548,521€ apo rreth 94.4% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të mirëmbajtjes dhe riparimeve, shërbimeve kontraktuese, shërbimeve komunale, blerjen e pajisjeve, etj.

Çështja B3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Gjatë testimit të shpenzimeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejtur që në katër (4) raste janë ekzekutuar pagesa në vlerë totale prej 23,043€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Këto pagesa kanë të bëjnë me renovimin e xhamisë në fshatin Hamidi dhe subvencionimin e OJQ-së e cila sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me komunën, duhet t'i furnizojë shkollat e komunës së Obiliqit me robot edukativ.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna kishte planifikuar këto projekte në kategorinë jo adekuate të shpenzimeve.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve kanë ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse dhe për efekt kanë paraqitjen jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna, në PVF-të e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,788,298€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 1,391,453€, dhe të tjerat nga taksat për leje biznesi, taksat nga shitja e banesave dhe nga qiraja komunale, taksat nga shfrytëzimi i pronës publike etj.

Çështja B4 - Mangësi në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L- 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2023 ishin gjithsej 1,788,298€, prej të cilave 1,391,452€ apo 77% ishin për tatimin në pronë. Në krahasim me vitin paraprak, ato ishin rritur për 409,849€. Komuna kishte dërguar kërkesë të inicimit të procedurës përmbarimore, ndaj disa debitorëve për përmbarim dhe detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë, megjithatë nuk kishte rezultate efektive në arkëtimin e këtyre borxheve. Më tutje, komuna nuk kishte marrë veprime tjera lidhur me arkëtimin e borxheve.

Poashtu, tek kontratat për shfrytëzimin e pronave publike si dhe kontratat e qirasë së banesave, ku parashihet se nëse nuk paguhet qiraja dhe taksat tjera komunale, Autoriteti ka të drejtë shkëputjen e kontratës, ndonëse nuk janë bërë pagesat nga shfrytëzuesit e pronave, komuna nuk ka marrë veprime sipas të drejtave të saj.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së të arkëtueshmeve.

Ndikimi Mosinkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor të brendshëm. Për vitin 2023, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar 4 auditime të rregullta. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 23 rekomandime. Prej tyre 12 ishin zbatuar dhe 11 ishin në proces të zbatimit. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Vlen të ceket se Komiteti i Auditimit nuk ishte plotësisht funksional përgjatë vitit, ngase kishte mbajtur vetëm dy takime, meqë rast edhe Kryesuesja e Komitetit në fund të vitit 2023 kishte dhënë dorëheqje.

Çështja C2 - Mos realizimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm dhe mos funksionimi i plotë i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Sipas planit vjetor të punës për vitin 2023, NJAB kishte planifikuar të kryej katër (4) auditime dhe ai pritet të realizohet brenda vitit në përputhje me afatet e përcaktuara. Sipas nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në sektorin publik, takimet e Komitetit mbahen së paku 4 herë në vit dhe ftohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Auditori i Brendshëm gjatë vitit 2023 kishte realizuar vetëm tre auditime nga katër të planifikuara. Auditimet e kryera kanë të bëjnë me menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, pasurive jo financiare dhe menaxhimin e dokumenteve, shërbimeve dhe të hyrave nga Drejtoria e Administratës.

Përpos kësaj, Komiteti i Auditimit nuk ka mbajtur katër takime që janë obligative, por ka mbajtur vetëm dy (një në muajin mars dhe një në dhjetor të vitit 2023).

Mospërbushja e planit të auditimit kishte ndodhur për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit në NjAB, ndonëse Komuna përmes konkursit të jashtëm ka bërë përpjekje për rekrutim të stafit për këtë njësi. Në anën tjetër, kjo është reflektuar edhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes vlerësimit të aktivitetit të auditimit në përbushjen e planit nga Komiteti i Auditimit. Mosfunksionimi efektiv i KA ka ndodhur për shkak të moszbatimit në përpikmëri të kërkesave ligjore për shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut dhe të mjedisit të kontrollit të brendshëm nga Komiteti i Auditimit.

Ndikimi

Mospërbushja e planit të auditimit mund të rezultojë që auditimi i brendshëm të mos mbulojë fushat me rrezik dhe t'i pamundësojë menaxhmentit marrjen e vendimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohë. Mosfunksionimi i plotë i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të plotësojë stafin e NjAB-së me staf të nevojshëm siç parashihet me kërkesat ligjore, në mënyrë që të arrihet realizimi i planit vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, në mënyrë që të ofrohet mbështetja dhe siguria menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe. Kryetari duhet të sigurojë se roli, puna dhe misioni i KA po përbushet në mënyrë që të arrihen objektivat e synuara të Organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,921,229	14,393,654	14,117,020	11,755,534	10,610,302
Grante Qeveritare - Buxheti	11,836,792	12,496,770	12,470,533	10,319,764	9,300,101
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	76,464	20,389
Të bartura nga viti i kaluar	0	353,133	312,876	366,512	412,225
Të hyrat vetanake	1,084,437	1,084,437	942,285	967,591	877,427
Donacionet vendore	0	730	30	25,203	160
Donacionet e jashtme	0	458,583	391,296	0	0

Buxheti final i Komunës së Obiliqit është më i lartë se buxheti fillestar për 1,472,425€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 659,978€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 353,133€ dhe donacioneve në vlerë prej 459,313€ në buxhet final.

Në vitin 2023, Komuna ka shpenzuar rreth 98.1% të buxhetit final ose 14,117,020€, me një rritje prej 5% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,921,229	14,393,654	14,117,020	11,755,534	10,610,302
Pagat dhe mëditjet	4,500,000	5,159,978	5,159,747	4,238,004	4,240,542
Mallrat dhe shërbimet	1,550,000	1,639,776	1,548,521	1,430,204	1,129,767
Komunalitë	380,000	415,861	268,622	259,195	255,179
Subvencionet dhe transferet	1,000,000	1,017,262	996,393	1,090,132	931,713
Investimet Kapitale	5,491,229	6,160,776	6,143,736	4,737,999	4,053,101

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 659,978€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 5,095,978€, pastaj nga të hyrat vetanake prej 64,000€. Për periudhën janar - dhjetor 2023 realizimi i buxhetit ishte 99.9%
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 89,776€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 1,384,500€, të hyrave vetanake prej 165,500€, të hyrave të bartura prej 22,466€ dhe donacionet në vlerë prej 67,310€; Deri në fund të vitit 2023 realizimi i buxhetit ishte 94.4%;
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 35,861€. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar 280,000€, të hyrave vetanake në vlerë prej 100,000€ dhe të hyrat vetanake të bartura prej 35,861€; Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 64.6%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 17,262€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 450,000€, të hyrave vetanake prej 550,000€ dhe të hyrave vetanake për bartje prej 17,262€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 98%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 669,547€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 5,286,292€, të hyrave vetanake prej 204,937€, të hyrave vetanake për bartje prej 277,544€ dhe donacioneve prej 392,003€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj 99.7% të buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Obiliqit në 2023 ishin në vlerë 899,270€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, lejet mjedisore , taksat administrative , participimet, të hyrat nga qiraja, etj.

Gjithashtu në vitin 2023, Komuna e Obiliqit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik në vlerë prej 200,236€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto mjete i planifikon dhe realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,084,437	1,084,437	899,270	1,129,173	1,031,656
Të hyrat tatimore	474,610	474,610	449,466	423,468	373,705
Të hyrat jo tatimore	609,827	609,827	449,648	705,705	657,950
Të hyrat tjera	0	0	156		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Obiliqit ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar; dy (2) ishin në proces dhe katër (4) nuk ka filluar zbatimin ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që mbështetja financiare për OJQ-të, të bëhet me thirrje publike sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore.	Nuk janë hasur raste të subvencionimit pa thirrje publike.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullt të raporteve të detyrimeve të papaguara, njëherit duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.	Nuk ka pasur raste të vonesave në pagesa, ndërsa vendimet gjyqësore kane ardhur si rezultat i zbatimit të kontratës kolektive, dhe kjo çështje është trajtuar te konkluzioni i kapitullit 2 "Gjetjet dhe rekomandimet"	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari të siguroj që të gjitha pronat pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Po ashtu, të siguroj që të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien e tyre në shfrytëzim.	Gjatë vitit 2023, ne sërish kemi hasur në raste të shfrytëzimit të pronave komunale pas përfundimit të kontratës. Komuna ka siguruar një raport monitorimi ku ka bërë identifikimin e pronave, në mars të vitit 2024, por që ende nuk janë marrë masa konkrete në zhvillimin e procedurave sipas kërkesave ligjore.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.	Nga mostrat e testuara në fushën e pagesave për projekte, nuk kemi hasur në raste ku janë bërë tejkalime të kontratës kornizë.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se komisioni për vlerësim bënë vlerësimin e duhur të ofertave duke mos shmangur gabimet aritmetikore në asnjë rast. Po ashtu duhet te kërkoj përgjegjësi nga kompania projektuese ngase kanë rrjedhur ndryshime në paramasën për të cilën veç se ka paguar komuna kompaninë projektuese.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar

6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas të ligjit për zyrtarët publik. Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit duhet të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurrimeve të SIMBNj-së dhe ueb faqes së komunës.	Rekomandimi ishte implementuar, ngase në vitin 2023 Drejtoria e Arsimit procedurat e rekrutimit i kishte zhvilluar përmes SIMBNJ.	I zbatuar
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë autorizuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se kërkesa për kompensim bëhet brenda afatit të paraparë kohor.	Nga mostrat e testuara për punë shtesë jashtë orarit kemi vërejtur se rekomandimi është implementuar ngase gjatë vitit 2023 për kompenzimet jashtë orarit janë bërë autorizimet e nevojshme nga menaxherët dhe kërkesat për punë jashtë orarit janë bërë brenda afateve të parapara kohore.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP sipas kërkesave ligjore.	Nga mostrat e testuara në fushën e prokurimit, nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore.	Nga mostrat e testuara në fushën e prokurimit, nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar

10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatëse ekonomike, me tutje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare.	Këtë vit nuk kemi vërejtur pagesa të buxhetuara dhe të shpenzuara gabimisht nga investimet kapitale, mirëpo rekomandimi mbetet i pazbatuar si rezultat i testimit të mostrave ku kemi hasur në keq klasifikim të shpenzimeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve të cilat është dashur të paguhen nga subvencionet dhe transferet.	Nuk ka filluar zbatim
11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Edhe këtë vit janë hasur raste ku urdhërblerja dhe zotimi janë procesuar pas pranimit të faturës.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se njësia kërkuese do të përgatisë paramasen dhe parallogarinë sipas sasive indikative, me qëllim të shmangies së keqpërdorimit të mundshëm nga zhvillimi i procedurave të prokurimit sipas poentimit.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë kapitale të jenë të regjistruara në regjistrin kontabël, po ashtu të sigurojë se pasurive jo kapitale iu llogaritet zhvlerësimi sipas normave përkatëse, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Sa i përket aplikimit të zhvlerësimit të e-pasuria kjo është zbatuar, megjithatë mos regjistrimi i pasurive kapitale është përsëritur edhe këtë vit.	Pjesërisht i zbatuar
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.	Nuk janë marrë masa të mjaftueshme në mbledhjen e borxheve nga departamentet përkatëse.	Nuk ka filluar zbatim

15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet për plotësimin e NjAB-së me staf të nevojshëm, me qëllim të shtimit të kapaciteteve njerëzore, në mënyrë që të arrihet realizimi i planit vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, dhe se kërkesat ligjore për raportim nga NjAB realizohen brenda afateve të përcaktuara me rregulloren përkatëse.	Rekomandimi është implementuar pjesërisht, ngase në vitin 2023, nuk ishte permbushur plani vjetor i auditimit të brendshëm, ndërsa nuk ka pasur vonesa në raportimin e NjAB në NjQHAB.	Pjesërisht i zbatuar
-----	----------------------	---	--	----------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit



Nora Rashiti Nishefci, Anëtare e ekipit



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 02-020-01-16806-24
No. Broj. No. 17
Data / Datum / Date 12.06.2024
OBILIQ - OBILIC - OBILIC



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Xhafer Gashi

(Kryetar Komuna Obiliq)

Data: 11.06.2024, Obiliq



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.